

EU Support for Rule of Law - Republic of North Macedonia

KOMPONENTI 4 – TË DREJTAT E NJERIUT DHE SANKSIONET ALTERNATIVE

KONKURS – Ekspert kombëtar afatmesëm në fushën e komunikimit dhe ndërgjegjësimit (Komponenti 4) në kuadër të projektit Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit

Punëdhënësi: Instituti Ludwig Boltzmann i të Drejtave Themelore dhe të Njeriut

Lokacioni: Shkup, Maqedonia e Veriut

Lloji: angazhim afatmesëm

Fillimi i pritshëm: Tetor 2021

Kohëzgjatja e pritshme: 12 muaj, Tetor 2021 – Tetor 2022

HISTORIA

Eksperti kombëtar afatmesëm për komunikim dhe ndërgjegjësim do të punojë si pjesë e ekipit implementues për projektin e mbështetur nga granti i Bashkimit Europian “Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit” në Maqedoninë e Veriut. Projekti zbatohet nga një partneritet ndërkombëtar me përvojë i udhëhequr nga Agjencia për Integrim Europian dhe Zhvillim Ekonomik GmbH dhe tre bashkë-aplikantë – Ministria e Drejtësisë dhe Administratës e Republikës së Kroacisë, Ministria e Brendshme e Republikës së Austrisë dhe Instituti Ludwig Boltzmann i të Drejtave Themelore dhe të Njeriut.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të forcojë sundimin e ligjit në Maqedoninë e Veriut. Komponenti 4 e zbaton objektivin e mëposhtëm specifik: Të rrisë mbrojtjen e të drejtave themelore. Për ta arritur këtë, Komponenti synon të prodhojë 8 rezultate që lidhen me:

- Forcimi i kapaciteteve të organeve kryesore të të drejtave të njeriut për të zbatuar në mënyrë efektive mandatet e tyre
- Forcimi i kapaciteteve të Zyrës së Avokatit të Popullit dhe Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi si organe kryesore mbikëqyrëse të të drejtave të njeriut
- Vlerëson dhe forcon kapacitetet për zbatimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut brenda administratës publike
- Përmirësimi i parandalimit të dhunës me bazë gjinore dhe diskriminimit me bazë gjinore
- Forcimi i politikës së të drejtave të fëmijës dhe sistemit të mbrojtjes së fëmijës
- Të rrisë ndërgjegjësimin mbi rëndësinë dhe rolin e institucioneve dhe organeve të ndryshme të të drejtave të njeriut për të mbrojtur të drejtat e njeriut
- Përmirësimi i respektimit të të drejtave të njeriut në sistemin gjyqësor dhe sistemin e punëve të brendshme
- Përmirësimi i sistemit të lirit me kusht dhe aplikimi i sanksioneve alternative

EU Support for Rule of Law - Republic of North Macedonia

Eksperti kombëtar afatmesëm për komunikim dhe ndërgjegjësim do të mbështesë ekipin e projektit në përmbushjen e një sërë detyrash që lidhen me të drejtat e njeriut dhe do të kontribuojë ndjeshëm në rezultatet dhe aktivitetet e lartpërmendura që lidhen me komunikimin dhe ngritjen e vetëdijes.

Kjo përfshin: aktivitetet e dukshmërisë së projektit; mbështetje për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë dhe rolin e organeve të ndryshme të të drejtave të njeriut, veçanërisht Zyrës së Avokatit të Popullit dhe Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi; ngritja e vetëdijes për të drejtat e fëmijëve; dhe ndërgjegjësimi mbi sanksionet alternative të burgimit.

Eksperti do të përfshihet në zgjedhjen e mesazheve, kanaleve dhe formateve të duhura për audiencën e synuar, për rezultatet e ndryshme të Komponentit dhe do të dizajnojë dhe zbatojë komunikimin përmes mjeteve të ndryshme, duke përfshirë aktivitetet online dhe mediat sociale, por edhe deklaratat për shtyp, tryeza të rumbullakëta dhe mjete të tjera të komunikimit të synuar. Ekspertët duhet të zhvillojnë, në bashkëpunim të ngushtë me palët e interesuara të përfshira dhe në bashkëpunim me ofruesit e tjerë të shërbimeve profesionale (dizajner, fotograf, etj.) materiale promovuese dhe informative lidhur me të drejtat e njeriut, qasjen ose mbështetjen në drejtësi, mjetet juridike në dispozicion dhe masat parandaluese. Grupet e synuara do të ndryshojnë nga pranuesit e komunikimit të brendshëm në organet e të drejtave të njeriut, publiku i gjerë, vendimmarrësit dhe grupet e veçanta të pakicave deri tek ekspertët, gjyqtarët dhe prokurorët, oficerët e policisë, personat e dënuar për kryerjen e një krimi, fëmijët dhe viktimat e dhunës ose shkeljet e të drejtave të njeriut ose personat që përballen me diskriminim. Çështjet e përsëritura që do të komunikohen do të jenë informacioni bazë mbi të drejtat e njeriut të mbrojtura nga legjislativi në Republikën e Maqedonisë së Veriut, rolet dhe mandatet e organeve mbikëqyrëse të të drejtave të njeriut dhe mënyrat për të pasur qasje në mbështetjen e tyre, si dhe mënyrat konkrete që i trajtojnë këto organe, raportet ose ankesat e paraqitura në vëmendjen e tyre. Rritja e ndërgjegjësimit mbi funksionin dhe përfitimin e mjeteve alternative ndaj burgimit do të jetë një sfidë tjetër e vazhdueshme. Çështje të tjera do të jenë trajtimi i storjeve të suksesit, si dhe trajtimi i mangësive në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Të dizajnojë dhe zbatojë aktivitete të ndërgjegjësimit të të gjitha llojeve - tryeza të rumbullakëta, konferenca, media sociale, punë rreth shtypit, buletin informativ, podkaste, blogje, vlog, etj...
- Të bashkëpunojë drejtpërdrejt me përfituesit për të vlerësuar, mbështetur dhe rritur dukshmërinë e tyre dhe promovimin e roleve dhe përgjegjësisë të tyre
- Të zhvillojë komunikim të qartë me grupet e ndryshme të synuara mbi të drejtat e tyre të njeriut dhe përgjigjet institucionale ndaj shkeljeve të mundshme të tyre
- Të zhvillojë plane dhe masa për ndërgjegjësim në bashkëpunim me ekipin e projektit dhe palët e interesuara
- Të zhvillojë materiale promovuese dhe informacione mbi temat e të drejtave të njeriut
- Të zhvillojë materiale promovuese mbi lirimin me kusht dhe sanksionet alternative
- Të bashkëpunojë me ofruesit e tjerë të shërbimeve profesionale në fushën e komunikimit, kompanitë e marketingut, fotografët, dizajnerë të ueb faqeve, specialistët e planifikimit, etj. sipas nevojës për të arritur rezultatet e pritshme
- Të mbështesë Liderin e Komponentit për Komponentin 4 në detyrat e tij në lidhje me dukshmërinë dhe ndërgjegjësimin, përfshirë përgatitjen e eventeve dhe punëtorive

EU Support for Rule of Law - Republic of North Macedonia

KËRKESAT

- Rrjedhshmëri në gjuhën angleze dhe maqedonase, në të shkruar dhe të folur
- Arsimit relevant, me mundësi diplomë universitare në komunikim, PR, menaxhim të mediave sociale ose përvojë e ngjashme në fushat përkatëse
- Përkushtim të fortë ndaj çështjeve dhe vlerave të drejtave të njeriut
- Përvojë e dëshmuar për mbajtjen e komunikimit të mirë për tema të veçanta për klientë ose institucione (minimum 5 vjet)
- Përvojë e dëshmuar dhe shkathtësi në zhvillimin e aktiviteteve për ndërgjegjësim (ju lutemi jepni shembuj, linqe etj. për punën e mëparshme)
- Shkathtësi teknike lidhur me online komunikimin
- Përvojë e dëshmuar në zhvillimin e përmbajtjes për ueb faqe dhe kanalet e mediave sociale (minimumi 5 vjet)
- Përvojë në bashkëpunimin me profesionistë në fushën e komunikimit, fotografë, dizajnerë të ueb faqeve, specialistë të planifikimit, etj. (minimumi 5 vjet)
- Gjykim dhe kreativitet i shkëlqyer estetik (ju lutemi jepni shembuj të punës së mëparshme)
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi ndërpersonale
- Ndjeshmëri e fortë ndaj ligjërimit dhe gjuhës në lidhje me grupe ose tema të veçanta
- Aftësi të fuqishme të rrjetëzimit
- Qasje pragmatike, e fortë, në të menduarit strategjik dhe planifikimin operacional.
- Fleksibilitet, aftësi të forta për t'u përshtatur dhe aftësi për punë ekipore në një mjedis potencialisht stresues nën afate të ngushta
- Siguri dhe besueshmëri, si dhe vëmendja ndaj detajeve

DORËZIMI I APLIKACIONEVE

Aplikacionet duhet të dërgohen në dieter.schindlauer@rol.mk deri më 29.09.2021, duke shënuar "National Mid-Term Expert communication and awareness raising" në titullin e e-mail-it (subject) dhe duke përfshirë një CV të formatit Europass në gjuhën angleze dhe një letër motivuese. Aplikacionet e dërguara pas përfundimit të afatit ose aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në një listë më të ngushtë do të ftohen për një intervistë personale.

Eksperti i përzgjedhur do të nënshkruajë një kontratë me Institutin Ludwig Boltzmann për të Drejtat Themelore dhe të Njeriut. Do të jetë përgjegjësia e tij/saj e vetme të jetë në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore për këtë kontratë, si dhe të mbulojë të gjitha taksat dhe tarifat e parashikuara.